Komiteti për Politikë dhe Financa
01.Nr.IV
Deçan,dt.24.04.2023

PROCESVERBAL

I mbajtur për mbledhjen e IV-të të rregullt të KPF-së , me dt.24.04.2023.
Në mbledhje merrnin pjesë: 6 anëtar të KPF-së (mungon Hyri Dobrunaj), drejtoresha e drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Dafina Cacaj, dhe Zyrtarja për informim.
Mbledhjen e kryesoj dhe e udhëhoqi, kryesuesi i KPF-së, zotëri Hajdar Sutaj.
Për mbledhje ishte propozuar dhe u miratua ky Rend i punës:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2023-2027,
3. Rishqyrtim i vendimit të dt.28.02.2023 për bartje të hyrave vetanake nga viti paraprak 2022 në vitin aktual fiskal 2023,
4. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2023,
5. Shqyrtimi i kërkesave,
6. Të ndryshme.

Kryesuesi- e hapi mbledhjen e katërt të rregullt të KPF-së për vitin 2023, pastaj e prezantoj rendin e punës i cili miratohet njëzëri.
I.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
Miratohet procesverbali njëzëri pa vërejtje.
II. Shqyrtimi i Strategjisë për Informim dhe Komunikim 2023-2027.
Kryesuesi e ka prezentu Strategjinë për Informim dhe Komunikim 2023-2027, ka deklaruar se këtu prezent e kemi zyrtaren për informim për të dhënë sqarime rreth strategjisë, pastaj e ka hapë debatin.
Njëzëri Draft-Strategjia për Informim dhe Komunikim 2023-2027, kalon në asamble për shqyrtim, atje debatohet rreth saj.
III.Rishqyrtim i vendimit të dt.28.02.2023 për bartje të hyrave vetanake nga viti paraprak 2022 në vitin aktual fiskal 2023.
Kryesuesi- e ka prezentu këtë pikë pastaj për sqarime fjalën ia kalon drejtoreshës së Drejtorisë për Buxhet dhe Financa.
Drejtoresha buxhetit, znj.Dafina Cacaj- ka sqaruar se vendimi për bartje të hyrave vetanake të vitit 2022 në vitin aktual fiskal 2023, i miratuar në mbledhjen e kuvendit të dt.28 Shkurt, na është kthye nga Ministria e Financave pas vlerësimit të ligjshmërisë, dhe na është thënë se janë kthye për arsye se nuk janë orientu aty ku kanë qenë të destinuara në vitin 2022.
Njëzëri kalon për shqyrtim në kuvend, atje debatohet prap.
IV. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2023.
Kryesuesi- e ka prezentu Raportin e shpenzimeve për periudhën 01 Janar- 31 Mars 2023, ka thënë se drejtoreshën e kemi prezent për të dhënë sqarime, pastaj e ka hapë debatin rreth raportit tre mujor të shpenzimeve.
Njëzëri përcillet për kuvend pa debat.
V.Shqyrtimi i kërkesave.
1.Kërkesa e Fondacionit humanitar "Dhuro edhe ti", në vlerë 5000 €.
Kryesuesi e ka prezentu kërkesën e Fondacionit humanitar "Dhuro edhe ti" me të cilën nga komuna kërkohet përkrahja financiare në shumën prej 5000 euro.

Vatan Istrefaj- thotë se jam në dijeni për punën dhe angazhimet e këtij fondacioni, por nuk është i vetmi i kësaj natyre që vepron te ne, dhe mund të bëjnë kërkesë edhe të tjerët dhe nuk di sa jemi në gjendje financiare që ti ndihmojmë, përndryshe jam për mi përkrahë këtë fondacion.
Drejtoresha buxhetit, Dafina Cacaj- ka sqaruar, se ne e kemi pasë të publikuar thirrjen publike për aplikim për ti subvencionuar OJQ-të që operojnë në komunën e Deçanit, në këtë thirrje publike kanë aplikuar disa OJQ, mirëpo ky fondacion nuk ka aplikua, por unë e kam krye obligimin ligjorë dhe unë nuk mund të zhvilloj asnjë procedurë që është në kundërshtim me ligjin dhe, edhe nëse ju e miratoni unë nuk mund e ekzekutoj një vendim që bie ndesh me procedurat ligjore.
Faton Selmanaj- thotë se kjo OJQ është dashtë që bashkë me kërkesën mi bashkangjitë edhe një raport të punës për vitin 2022, çka kanë dhurua saktësisht dhe çka kanë bërë me mjetet e grumbulluara saktësisht.
Yllarta Thaqi- thotë se është e vetmja OJQ që po i prekë familjet me nevojë, dhe a mundemi na me i dhanë një rekomandim që ata me i pru ato çka tha Fatoni, dhe mi qu në kuvend si kërkesë, atje ka edhe ma shumë anëtarë dhe e debatojmë dhe vendosim bashkarisht.
Florim Mataj- thotë, ne nuk kemi nevojë me ba nera me buxhet të komunës, por ma mirë është këto mjete me ja dediku Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, e ata me i nda sipas listës së personave me nevojë që posedon shërbimet sociale.
Vatan Istrefaj- thotë, meqenëse u deklarua drejtoresha e buxhetit për procedurat që duhet ti zhvillon, të cilat sipas ligjit duhet të shkojnë me thirrje publike, dhe miratimi i kësaj kërkese në KPF nuk mund të ekzekutohet në këtë formë, përndryshe vetëm një plan të punës sikur ta kishin prezentu këta kishte qenë e mjaftueshme dhe nuk ka pasë nevojë për raport, sepse e kemi pa të gjithë çka kanë punua këta.
Armend Loshaj- ma mirë kishte me qenë që 5000 euro me ja qitë Klubit të futbollit-meshkujt, sepse e kanë një kërkesë për përkrahje financiare.
Kryesuesi e qiti në votim, anëtarët e KPF-së me 3 vota për, 2 kundër dhe 1 abstenim e miratojnë kërkesën e Fondacionit Dhuro edhe ti në shumën prej 5000 euro.
Drejtoresha Buxhetit, Dafina- edhe një herë është deklaruar se nuk ka mundësi zbatimi të kësaj kërkese sepse shkelen procedurat e konkurrimit me Thirrje publike për aplikim për përkrahje financiare OJQ-ve dhe do të përkrahen vetëm ato OJQ të cilat kanë aplikuar në formë të rregullt sipas Thirrjes publike.
2.Kërkesa e Komitetit të Komuniteteve për përkrahje financiare të familjes Qekiqaj nga Pemishta.
Kryesuesi- e ka prezentu kërkesën, pastaj ka shtuar se këta duhet së pari ti shterrin të gjitha mundësitë te Ekzekutivi e pastaj ti drejtohen KPF-së.
Florim Mataj- propozon që kërkesa ti drejtohet Qendrës për punë sociale, ata me shku mi pa gjendjen në teren, pastaj ata mi kanalizu kërkesën.
Rekomandim: KPF pas shqyrtimit të kësaj kërkese rekomandojnë që Kërkesa duhet të përcillet për shqyrtim në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, ata përmes Qendrës për Punë sociale mi trajtu kërkesën, me dalë në teren mi pa gjendjen dhe me vendosë lidhur me te.
Kryesuesi- i falënderoj pjesëmarrësit për kontributin e dhënë pastaj e shpalli mbledhjen për të mbyllur.

Procesmbajtëse
Dyke Llolluni

Kryesuesi i KPF-së
Hajdar SUTAJ